

Pas kundërshtimeve nga deputetët mistreca të Edvin Rames dhe protestës së një grupi halabakësh për parlamentin kundër projekt-ligjit të importimit të mbetjeve, Kuvendi i Shqipërisë ka rrezuar me 73 vota dekretin e presidentit Topi për diskutim.



Kryeministri Berisha pasi u vu në dijeni se tek-tuk nga populli nuk ishin në një mendje me planet e tij historike siameze ka dalë në foltoren e parlamentit të tij dhe ka sqaruar me hollësiht në lidhje me plehrat.

“Brenda pak vitesh fale punës time kolosale i kam kthye malet dhe kodrat në brezare me ullinj, agrume dhe pjeshka. Kam begatue çdo cep të pasurisë time...me falni se jam i emocionue, kam begatue çdo cep të Shqipnisë time e cila asht ba kopesht me lule.

Por cdo bahcevan ne bote e di se lulet qe te rriten duan pleh ose plehra. Madje plehra organike. Por ju e dini se qeveria ime asht ne diete sepse une e kam shkurtue organiken ne administrata. Pra asht ba keq per organike dhe plehra organike.

Edvin Rama donte te trembte popullin votues duke i thane se Shqipnia do mbushet me plehra. More zotni, po Evropa ka vite qe eshte ne krize buke dhe ata nuk kane fare plehra se kur nuk kane cfare te hane, nuk kane as cfare te hedhin neper plehra.

Pas suksesit historik-siamez "Blue Albania" tani e ka rrathen nisma jone e ardhshme "Pleh Albania" e mbylli fjalen e tij Berisha

Me pas kryeministri Sali Berisha falenderoi deputetet e tij per mirekuptimin blu dhe deputete e falenderuan shefin per falenderimin.